



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:167591

Datë: 11.02.2022

Numri i dokumentit: 02706769

PKR.nr.169/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. G. për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 1 te KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.150/21, të dt. 25.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit publik fillestar me datë 01.02.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Sahide Gashi, të pandehurit L.G. dhe të dëmtuarës T. M.-G.. në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.11.02.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

L.G. i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në Pejë, me vendbanim Pejë rr., me lnr.nr....., ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I .Më dt. 17.07.2021 rreth orës 08:37 min., në Pejë në rr., pikërisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit dhe atë të dëmtuarën-bashkëshorten e tij T. M., në atë mënyrë që pasi i pandehuri i drejtohet të dëmtuarës më fjalët “mos mi lerë fëmijët te shkojnë në dhomën e fjetjes së do ta vras vetveten” duke ia shkruar edhe disa së mesazhe më përmbajtje që ti largoj fëmijët nga shtëpia, e dëmtuara shkon tek shtëpia e fqinjit të

saj F. G., dhe në ato momente i pandehuri e thërret të dëmtuarën në telefon që të kthehet në dhomën e tij, mirëpo pasi e njëjta nuk i përgjigjet, i pandehuri del jashtë shtëpisë dhe pasi e takon të dëmtuarën e kanos më fjalët “Do të vras, ti nuk dëgjon” dhe fjalë të tjera dhe duke ia drejtuar armën.

-me çka ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 4 të KPRK-së

II. Më parë e gjer më dt. 17.07.2021, në Pejë, në shtëpinë e tij, mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë dhe atë një pistoletë të cal. ... mm. më nr. serik ..., si dhe tre (3) fishek të gjallë të cal. ... mm, në atë mënyrë që policia në lidhje më rastin e kanosjes me armë të të dëmtuarës T. M., shkojnë tek i pandehuri për bastisje dhe pas kontaktit më të njëjtin gjejnë armën dhe municioni i përshkruar si më lartë, e cila më pas i sekuestrohet nga ana e policisë.

-me çka ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,46,47,48,49,50, 69, të KPRK-së, nenit 181 par. 4, 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

- Për veprën penale nga **dispozitivi i I-rë**, i këtij aktgjykim te pandehurin e gjykon me dënim me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e i cili dënim fare nuk do te ekzekutohet nëse në afat prej **2 (dy) vite**, nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Për veprën penale nga **dispozitivi i II-të**, i këtij aktgjykim te pandehurin e gjykon me gjobë në shumë prej 300 (treqind)euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Të pandehurit i konfiskohet një pistoletë të cal. ... mm. më nr. serik ..., si dhe tre (3) fishek të gjallë të cal. ... mm.

I pandehuri obligohet që ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20(njëzet) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që ne emër te programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë)euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara T. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.150/21, me dt. 25.10.2021, ndaj të pandehurit L.G. për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 4 te KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 01.02.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ne prezencën e prokurorit të shtetit Prokurorit të Shtetit, Sahide Gashi, të pandehurit L.G. dhe te dëmtuarës T. M.-G.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaron se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për dy veprat penale të cilat i vihen në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ndihet i penduar, ka shtuar se tani nuk kanë më asnjë problem në mes veti, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

E dëmtuara, ka deklaruar se e pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk kërkon dëmshpërblim nga i pandehuri ka shtuar se tani raportet i kanë shumë të mira, nuk kanë asnjë problem në mes veti, i pandehuri nga dita kur kanë ndodh veprat i njëjti nuk i ka përsërit veprimet e njëjta, ka pasur sjellje shumë të mira.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi qe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit R. M. i dt. 19.07.2021, Raporti i oficerit V. D. i dt. 17.07.2021, Raporti i oficerit S. H. i dt. 17.07.2021, Deklarata e të pandehurit L.G. e dhënë në polici më dt. 17.07.2021 si dhe ajo e dhënë pranë kësaj prokurorie më dt. 20.10.2021, Deklarata e të dëmtuarës T.M. e dhënë në polici më dt. 17.07.2021 si dhe ajo e dhënë pranë kësaj prokurorie më dt. 20.10.2021, Deklarata e dëshmitares A. G. e dhënë në polici më dt. 17.07.2021,

Deklarata e dëshmitarit I. G. e dhënë në polici më dt. 17.07.2021, Deklarata e dëshmitares A. G. e dhënë në polici më dt. 17.07.2021, Vërtetimi mbi sekuestrimin e armës më nr. të rastit ...i dt. 17.07.2021, si dhe foto-albumi i rastit ..., si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit L.G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 181 par 4 të KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprat e kryera dhe premtimin, se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra tjera penal, faktin se e dëmtuar deklaroi se nga dita kritike nuk kanë pasur ndonjë problem tjetër dhe tani i kanë raportet shumë te mira, ndërsa rrethana rënduese ndaj te pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së konfiskohen një pistoletë të cal. ... mm. më nr. serik ..., si dhe tre (3) fishek të gjallë të cal. ... mm.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda,
PKR.nr.169/21, dt. 11.02.2022.**

Bashkëpunëtorë profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.